

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar
Advanced Financial Reporting

P9

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data
1.07.2017

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
1. Problemi 1	25	
2. Problemi 2	15	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Informatat në vijim janë ekstraktuar nga pasqyrat e pozitës financiare të Bismark sh.a, Solomon sh.a dhe Koral sh.a me 30 qershor 2016:

	Bismark sh.a € milion	Solomon sh.a € milion	Koral sh.a € milion
Pasuritë			
Prona, fabrika dhe paisjet	5,999	5,151	2,775
Investimet	2,550		
Stoqet	1,521	645	600
Llogaritë e arkëtueshme	735	300	315
Llogaria rrjedhese - Koral sh.a		105	
Paraja dhe banka	<u>178</u>	<u>450</u>	<u>375</u>
	10,983	6,651	4,065
Ekuiteti			
Aksionet e zakonshme prej €1.00 secila	7,550	3,000	1,500
Fitimi i mbajtur	1,200	1,650	987
Premia e aksioneve	67	200	168
Detyrimet			
8% Obligacione	975	1,020	900
Llogaritë e pagueshme	1,050	691	420
Dividenda e zakonshme e pagueshme	141	90	
Llogaria rrjedhese -Solomon sh.a			<u>90</u>
	10,983	6,651	4,065

Blerja e Solomon sh.a

Bismark sh.a bleu 40% të aksioneve të zakonshme në Solomon sh.a me 1 korrik 2014 me një kosto prej €1,500 milion kur fitimet e mbajtura dhe premia e aksioneve të Solomon sh.a ishin €810 milion dhe €200 milion respektivisht.

Me 1 janar 2016, Bismark sh.a bleu edhe 20% të aksioneve të zakonshme në Solomon sh.a për një konsideratë në para €1,050 milion. Në atë datë, vlera e drejtë e 40% të aksioneve fillestare të zakonshme të Solomon sh.a ishte €1,800 milion.

Me 1 janar 2016, vlerat bartese të pasurive neto të Solomon sh.a reflektuan vlerat e drejta të tyre me përjashtim të një fabrike. Vlera e tregut e fabrikës u zvogëlua së fundi dhe raporti i vlerësimit tregoi një zvogëlim prej €150 milion. Fabrika ka jetë të mbetur të përdorimit të fabrikës prej tre viteve nga ajo datë. Solomon sh.a nuk korigjoi librat e saj për të reflektuar vlerën e re.

Blerja e Koral sh.a

Bismark sh.a bleu 60% të aksioneve të zakonshme në Koral sh.a me 1 korrik 2015 kur fitimet e mbajtura dhe premia e aksioneve të Koral sh.a ishin €432 milion dhe €168 milion respektivisht. Kosto e këtij kombinimi biznesor do të përmbushej duke emetuar 600 milion aksione të zakonshme në Bismark sh.a. Vlera e drejtë e aksioneve të zakonshme të Bismark sh.a me 1 korrik 2015 ishte €2.50 secila. Ky këmbim i aksioneve nuk është regjistruar ende nga Bismark sh.a.

Me 1 korrik 2015 vlerat bartëse të pasurive neto të identifikueshme të Koral sh.a reflektuan vlerat e drejta të tyre.

Informata shtesë:

- i) Një e katërta e stoqeve të Koral sh.a ishte blerë nga Solomon sh.a me 1 qershor 2016. Stoqet janë faturuar me një kosto plus 25%.
- ii) Me 1 qershor 2016, Bismark sh.a shiti një pronë tek Solomon sh.a për €200 milion mbi vlerën e saj bartëse. Jeta e mbetur e përdorimit të kësaj prone ishte dhjetë vite.
- iii) Në fund të qershorit 2016, Koral sh.a deklaroi një dividendë finale të aksioneve të zakonshme prej 3 cent për aksion. Këto dividenda nuk janë regjistruar.
- iv) Bismark sh.a ende nuk e ka regjistruar pjesën e saj të dividendave nga aksionet e zakonshme në Solomon sh.a.
- v) Diferenca në llogaritë rrjedhëse është përshkak të parasë në transit.
- vi) Fitimet dhe humbjet e Solomon sh.a supozohet që ndodhin njëtrajtësisht nga 1 korrik 2014 deri me 30 qershor 2016.
- vii) Bismark sh.a mbajti të gjitha investimet e saj sipas koston.
- viii) Politika e zhvlerësimit e grupit është të zhvlerësoj të gjithë pronën, fabrikën dhe paisjet në baza drejtvizore, duke ngarkuar shumën për tërë vitin në vitin e blerjes.
- ix) Grupi vlerëson interesat jo-kontrollues sipas pjesës proporcionale të vlerës së drejtë të neto pasurive të filialeve në datën e blerjes.

Kërkohet:

Përgadite Pasqyrën e Konsoliduar të Pozitës Financiare të Bismark sh.a dhe grupit të tij me 30 qershor 2016. (25 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

	€mil	Zëri i mirë €mil	IJK €mil	FM €mil
Solomon sh.a				
KT (20%)		1,050		
+) VD e pronësisë më herët (40%)		1,800		
+) IJK (40% x 4,490)		<u>1,796</u>	1,796	
		4,646		
-) VDPN (1 jan 2016)				
AZ	3,000			
FM 810 + $[(1,650-810)/24 \times 18]$	1,440			
PA	200			
FM	<u>(150)</u>			
		<u>(4,490)</u>		
Zëri i mire		156		
Koral sh.a				
KT (600 x €2.50)		1,500		
+) IJK (40% x 2,100))		<u>840</u>	840	
		2,340		
-) VDPN (1 jan 2016)				
AZ	1,500			
FM	432			
PA	<u>168</u>			
		<u>(2,100)</u>		
Zëri i mire		240		

	€mil	Zëri i mirë €mil	IJK €mil	FM €mil
Fitimi i mbajtur (Solomon)				
Sal.	1,650			
-) Para	(1,440)			
-) FPR - Stoqet (600x25%x25/125)	(30)			
+) Zhvl. - Fabrika (150/3)	<u>50</u>			
	230		(40%) 92	(60%)138
Fitimi i mbajtur (Koral)				
Sal.	987			
-) Para	(432)			
-) Div. e zak. e pag.	<u>(45)</u>			
	510		(40%) 204	(60%) 306
Fitimi i mbajtur (Bismark)				
Sal				1,200
-) FPR - Prona				(200)
+) Zhvl - Prona				20
+) Div. e zak. e ark -Solomon				54
+) Div. e zak. e ark -Koral				27
+) VD - ndryshim (1,800-1,500)				<u>300</u>
PKPF			2,932	1,845

Pasqyra e Konsoliduar e Pozitës Financiare e Bismark sh.a me 30 qershor 2016

		€mil
Prona, fabrika dhe paisjet	[5,999+5,151+2,775] -150+50 - 200 +20	13,645
Zëri i mirë		396
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	[1,521+645+600] -30	2,736
Llogaritë e arkëtueshme	[735+300+315]	1,350
Paraja dhe banka	[178+450+375] +15	<u>1,018</u>
		19,145
Ekuiteti		
Aksionet e zakonshme	[7,550+600]	8,150
Fitimi i mbajtur		1,845
Premia e aksioneve	[67+900]	967
IJK		2,932
Detyrimet afatgjata		
Llogaritë e pagueshme	[975+1,020+900]	2,895
Detyrimet afatshkurtëra		
Llogaritë e pagueshme	[1,050+691+420]	2,161
Div. e zak. e pagueshme	[141+(90-54)+(45-27)]	<u>195</u>
		19,145

Problemi 2

a) Sipas SNRF 8 *Segmentet operative*, disa segmente operative mund të agregohen në një segment të vetëm operativ nëse segmentet kanë karakteristika të ngjajshme ekonomike.

Kërkohet:

Shpjego shkurtimisht se si të përcaktohet që segmentet kanë karakteristika të ngjajshme ekonomike. (5 pikë)

(b) Arafura sh.p.k mirret me shitjen e mjeteve motorike. Me 1 prill 2015 i shiti mjetet e saj motorike tek Sulu sh.p.k sipas kushteve në vijim:

- (i) Arafura sh.p.k mund të kërkoj nga Sulu sh.p.k të transferoj mjetet motorike tek një agent tjetër i shitjes pa u kompensuar. Arafura sh.p.k e ka bërë këtë në të kaluarën me agentët e tjerë të shitjes.
- (ii) Sulu sh.p.k mund të ngarkohet me një shumë si ndëshkim që është e barabartë me 5% çmimit aktual shitës të mjeteve motorike në rast se nuk i transferon mjetet motorike tek agjenti tjetër i shitjes.
- (iii) Sulu sh.p.k nuk ka të drejtë t'i kthejë mjetet motorike tek Arafura sh.p.k. Nëse Sulu sh.p.k do të kthente mjetet motorike tek Arafura sh.p.k do të ishte e detyruar të paguante një dënim prej 30% të çmimit aktual të tregut të mjeteve motorike që do të kthehen.
- (iv) Mjeteve motorike u është caktuar çmimi sipas çmimit të tyre të tregut në datën e dërgesës dhe nuk mund të ndyshohet nga Arafura sh.p.k për të reflektuar çmimin aktual të tregut të mjeteve motorike.

Arafura sh.p.k nuk është e sigurtë se si t'i trajtoj këto mjete motorike në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 mars 2016.

Kërkohet:

Diskuto se si Arafura sh.p.k duhet të trajtoj mjetet motorike në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 mars 2016. (10 pikë)

(15 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

a) Segmentet kanë karakteristika të ngjajshme ekonomike nëse:

1. Shfaqin performancë afatgjatë të ngjajshme

- Konsidero bruto marzhat mesatare afatgjatë
- Konsidero performancën e kaluar, aktuale, dhe të pritshme në të ardhmen
- Konsidero tregues të tjerë si matësit e shitjeve, kthimin në investime dhe matës të tjerë të standardizuar të industrisë.

2. Janë të ngjajshëm në disa aspekte përfshirë:

- Natyrën e produkteve dhe shërbimeve
- Natyrën e procesit të prodhimit
- Llojin apo klasën e konsumatorve për produktet dhe shërbimet e tyre.
- Metodatat e përdorura për të shpërndarë produktet e tyre apo kryer shërbimet.
- Nëse e aplikueshme, natyrën e ambientit rregullativ.

b) Trajtimi i mjeteve motorike në pasqyrat financiare të Arafura sh.p.k për vitin deri me 31 mars 2016 do të varet nëse Arafura sh.p.k ka transferuar apo jo rreziqet dhe shpërblimet e lidhura me pronësinë e mjeteve motorike tek Sulu sh.p.k. Dy kushtet e para të shitjes, sipas të cilave Arafura sh.p.k ka të drejtën të kërkojë nga Sulu sh.p.k të transferoj mjetet motorike tek një agjent tjetër i shitjes dhe që Sulu sh.p.k detyrohet të paguajë një ndëshkim nëse dështon të transferoj mjetet motorike sugjerojnë që mjetet janë ende në pronësi të Arafura sh.p.k. Megjithatë, Sulu sh.p.k nuk e ka të drejtën e kthimit të mjeteve motorike tek Arafura sh.p.k dhe nëse i kthen shkakton një ndëshkim të madh me një norme prej 30%. Për më tepër, Sulu sh.p.k-së i ngarkohet një çmim duke u bazuar në datat e dërgesës dhe jo në datën në të cilën janë shitur tek klientët e Sulu sh.p.k. Kjo nënkupton që rreziku i rënies së çmimit të tregut për mjetet motorike bartet tek Sulu sh.p.k. Kjo sugjeron që mjetet motorike janë në pronësi të Sulu sh.p.k në datën e dërgesës.

Konkluzion

Në përgjithësi, Arafura sh.p.k ende ka kontroll mbi mjetet motorike pasi që u ka kërkuar edhe agjentëve të tjerë të shitjes që të transferojnë mjetet motorike pa i kompensuar ata. Arafura sh.p.k duhet pra, të njohë mjetet motorike si stoqe të saj me datën 31 mars 2016 sipas SNK 2 *Stoqet*.

Problemi 3

(a) Në vijim janë ekstraktet e pasqyrave të konsoliduara financiare të Timor sh.a:

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjës për vitin e përfunduar me 31 mars 2016

	€'000
Të hyrat	1,800
Fitimi pas tatimit	300
Tatimi në fitim	60
Fitimi i atribuar te:	
Mbajtësit e ekuitetit të prindit	200
Interesave jo-kontrollues	40

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 mars 2016

	€'000
Ekuiteti	
Aksionet e ekuitetit prej €0.50 secila	320
Total rezerveat	520
Interesat jo-kontrollues	160
Detyrimet afatgjata	440

Timor sh.a përdor dy koeficientë kyq, kthimin në kapitalin e angazhuar (KNKA) dhe fitimin për aksion (FPA) për të vlerësuar performancën e saj. KNKA dhe FPA për vitin e përfunduar me 31 mars 2015 ishin 20% dhe €0.37 për aksion respektivisht.

Rishikimi i pasqyrave financiare individuale të Timor sh.a zbuloi si në vijim:

Transaksioni një

Stoqet që i kushtuan Timor sh.a €90,000 për ti blerë në dhjetor 2015 ishin shitur në prill 2016 për €85,000. Kostot e shitjes lidhur me këtë transaksion ishin €5,000.

Stoqet janë regjistruara në pasqyrat financiare të Timor sh.a dhe në pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e përfunduar me 31 mars 2016 sipas vlerës së tyre të dhjetorit 2015. Stoqet tjera janë shitur për më shumë se kostot e tyre respektive.

Pasqyrat e konsoliduar dhe individuale do të autorizohen për publikim me 31 maj 2016.

Transaksioni dy

Me 1 prill 2015, Timor sh.a morri një makinë për lakimin e hekurit me lizing dy vjeçar për një pagesë vjetore prej €20,000 e pagueshme me 31 mars të secilit vit. Makina kishte një jetë të vlerësuar të përdorimit prej pesë viteve. Kishte vlerë të drejtë prej €80,000 me 1 prill 2015. Norma vjetore e interesit e nënkuptuar në marrëveshjen e lizingut ishte 10%.

Makina është trajtuar në librat e konsoliduar të Timor sh.a sikur të ishin blerë nën lizing financiar dhe është zhvlerësuar përgjatë një periudhe pesë vjeçare duke u bazuar në vlerën e saj të drejtë me 1 prill 2015.

Shënim:

Timor sh.a nuk ka emetuar aksione shtesë të ekuitetit gjatë vitit deri me 31mars 2016. Injoro tatimin.

Kërkohet:

(i) Llogarite KNKA dhe FPA për vitin e përfunduar me 31 mars 2016. (4 pikë)

(ii) Ri-llogarit KNAK dhe FPA pas marrjës parasysht të transaksionit një dhe dy më sipër. (9 pikë)

(iii) Komento efektin në KNKA-në dhe FPA-në aktuale për vitin e përfunduar me 31 mars 2016 pasi që janë marrë parasysht transaksionet një dhe dy më sipër (2 pikë)

(b)

SNRF 11 *Aranzhimet e përbashkëta* klasifikon aranzhimet e përbashkëta në sipermarrje të përbashkët ose operacion të përbashkët.

Kërkohet:

Tregoni dallimin ndërmjet sipërmarrjes së përbashkët dhe operacionit të përbashkët. (5 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

a)

(i)

$$\text{KNKA} = \text{FPIT} / \text{KA} = (300+60) / (320+520+160+440) = 360 / 1,440 = 25\%$$

$$\text{FPA} = \text{FPT} / \text{Numri mesatar i ponderuar i aksioneve} \\ = 200 / 640(320/0.5) = \mathbf{\text{€}0.31 \text{ për aksion}}$$

$$\text{(ii) KNKA e rishikuar} = (360 - 6\text{L}12) / (1,440 - 6 - 54.8\text{L}11) = 25.67\%$$

$$\text{FPA e rishikuar} = (200-6) / 640 = \mathbf{\text{€}0.30 \text{ për aksion}}$$

L11 - Obligimet sipas lizingut financiar

	€'000
1.4.15 VD	80
31.3.16 Interesi @10%	8
31.3.16 Qiraja	<u>(20)</u>
31.3.16 Total detyrimi	68
31.3.17 Interesi @ 10%	6.8
31.3.17 Qiraja	<u>(20)</u>
31.3.17 E përfshirë në detyrimet afatgjat	54.8

L12 - Llogaritja e fitimit të korigjuar

	€'000
Transaksioni një	
Korigjimi i stoqeve 90 - (85 - 5)	(10)
Transaksioni dy	
Anulimi i zhvlerësimit 80/5	16
Anulimi i interesit L11	8
Qiraja	<u>(20)</u>
Korigjimi i fitimit	(6)

(iii)

KNKA është rritur nga 25% në 25.67% që paraqet një rritje prej 2.68%. FPA është zvogëluar nga €0.31 për aksion në €0.30 për aksion.

b)

Një operacion i përbashkët është një aranzhim i përbashkët ku palët që kanë kontroll të përbashkët të aranzhimit kanë të drejtë në pasuritë dhe obligimet për detyrimet që kanë të bëjnë me aktivitetet e aranzhimit. Marrëveshja kontraktuale përcakton të hyrat dhe shpenzimet e aranzhimit në bazë të performancës së secilës palë. Këto palë quhen operator të përbashkët.

Një sipërmarrje e përbashkët është një aranzhim ku palët që kanë kontroll të përbashkët të aranzhimit kanë të drejta në neto pasuritë e aranzhimit. Aranzhimi kontraktual përcakton pjesën e fitimit ose humbjes të secilës palë që ka të bëjë me aktivitetet e aranzhimit. Këto palë quhen sipërmarrës të përbashkët.

Problemi 4

Ju rishtazi keni ndjekur një seminar për Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Zyrtari Kryesor Ekzekutiv i kompanisë tuaj dëshiron që të ia shpjegoni trajtimin në kontabilitet të disa transaksioneve në pajtim me standardet e aplikueshme të kontabilitetit që kanë të bëjnë me njëri nga klientët tuaj, Mediteran sh.p.k.

(a) Transaksioni 1

Mediteran sh.p.k prezantoi dy skema të pensioneve, 'Adriatik' dhe 'Jon' me 1 prill 2014 për përfitim të punonjësve të saj. Informatat në vijim kanë të bëjnë me të dy skemat më datë 1 prill 2015:

Skema Adriatik

Sipas kësaj skeme obligimi i kompanisë është i kufizuar në kontribute vjetore fikse të saj prej €600,000. Anëtarët e kësaj skeme të pensioneve janë stafi i menaxhmentit të lartë të kompanisë.

Në vitin e përfunduar më 31 mars 2015, kompania bëri kontribute totale prej €520,000. Gjatë vitit deri me 31 mars 2016, janë bërë kontribute totale prej €700,000.

Regjistrimi i vetëm në librat e Mediteran sh.p.k në vitin e përfunduar me 31 mars 2016 ishte për të regjistruar pagesën në para prej €700,000 në librat e saj. Të gjitha regjistrimet tjera para vitit 2016 janë regjistruara saktë.

Skema Jon

Sipas kësaj skeme, kompania garanton përfitimet e punonjësve kur ata të arrijnë moshën 55 vjeçare ose pasi të kenë punuar për kompaninë për 25 vite, cilado që ndodh më herët. Anëtarësia e kësaj skeme të pensioneve përbëhet nga punonjësit që nuk janë menaxhër të lartë.

Këto informata kanë të bëjnë me skemen e pensioneve:

	€'000
Neto pasuritë e planit me 1 prill 2015	100
Kosto e shërbimeve aktuale	400
Kontributete e paguara	160
Përfitimet e pensioneve të paguara	80
Neto detyrimet e planit me 31 mars 2016	40
Norma e duhur vjetore e skontimit	12%

Gjatë vitit deri me 31 mars 2016, Mediteran sh.p.k korigjoi formulën e përdorur për të llogaritur përfitimet e pagueshme ndaj punonjësve. Kjo rezultoi me një zvogëlim prej €102,000 në përfitimet e pensioneve të pagueshme ndaj punëtorve.

Kontributet dhe përfitimet e punonjësve janë paguar të gjitha me 31 mars 2016.

Kompania ka regjistruara vetëm kontributet e paguara në pasqyrat financiare për vitin deri me 31 mars 2016.

Kërkohet:

Shpjego se si të dy skemat, Adriatik dhe Jon duhet të trajtohen në pasqyrat financiare të Mediteran sh.p.k për vitin e përfunduar me 31 mars 2016. (trego llogaritjet përkatëse në shpjegimet tuaja). (13 pikë)

(b) Transaksioni 2

Mediteran sh.p.k shiti mallra me kredi tek Egje sh.p.k me 1 prill 2015 për €400,000. Kushtet e shitjes ishin si në vijim:

- (i) Egje sh.p.k paguan Mediteran sh.p.k për mallrat vetëm pasi që ato janë paguar nga klientët e saj.
- (ii) Egje sh.p.k ka të drejtën të kthej çdo mall të pashitur. Kjo e drejtë është ushtruar më herët nga Egje sh.p.k.
- (iii) Mediteran sh.p.k nuk mund t'i kërkoj Egje sh.p.k-së ti kthej mallrat e pashitur tek ajo.

Egje sh.p.k nuk ka mundur të shesë asnjë prej mallrave të blerë nga Mediteran sh.p.k. Mediteran sh.p.k realizon një marzhë prej 25% mbi kosto në të gjitha shitjet e saj.

Mediteran sh.p.k e ka njohur një shitje dhe një llogari të arkëtueshme në pasqyrat e saj financiare për vitin e përfunduar me 31 mars 2016.

Kërkohet:

Diskuto përshtashmërinë e trajtimit në kontabilitet nga Mediteran sh.p.k të transaksioneve më sipër dhe rekomando, nëse duhet, korigjimet që duhet të bëhen tek pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 mars 2016 për të treguar trajtimin e duhur në kontabilitet të transaksionit.

(7 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

4.

Transaksioni 1

Skema Adriatik

Kjo është një skeme e kontributeve të paracaktuara pasi që obligimet e Mediteran sh.p.k-së janë të kufizuara në kontributet fikse vjetore prej €600,000. Mediteran sh.p.k duhet të njoh kontributin e tij fiks prej €600,000 si shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjës për vitin e përfunduar me 31 mars 2016. Mediteran sh.p.k duhet të njohë një parapagim prej €20,000 **L11** tek pasuritë qarkulluese në pasqyrën e pozitës financiare me 31 mars 2016.

Skema Jon

Kjo është një skeme e përfitimeve të paracaktuara pasi që Mediteran sh.p.k garanton përfitimet të cilat u takojnë punëtorve sipas skemes. Mediteran sh.p.k do të njohë një detyrim neto të planit prej €40,000 tek detyrimet afatgjata në pasqyrën e pozitës financiare me 31 mars 2016. Një shpenzim neto prej €286,000 **L12** duhet të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjës për vitin e përfunduar me 31 mars 2016 përderisa humbja neto nga vlerësimt e ekspertve prej €14,000 **L12** duhet të dërgohen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Transaksioni 2

Trajtimi i këtij transaksioni në librat e Mediteran sh.p.k do të varet nëse rreziqet dhe përfitimet që kanë të bëjnë me mallrat janë transferuar të Egje sh.p.k. Rreziqet dhe shpërblimet që kanë të bëjnë me mallrat nuk janë transferuar tek Egje sh.p.k. Kjo përshkak se Egje sh.p.k do t'i paguaj mallrat vetëm kur ato janë paguar nga klientët e saj. Për më tepër, Egje sh.p.k ka të drejtën e kthimit të ndonjë malli të pashitur tek Mediteran sh.p.k dhe e ka ushtruar këtë të drejtë më heret. Këto dy kushte tregojnë që rreziqet që kanë të bëjnë me borxhet e parevokueshme dhe vjetërsimin e stoqeve mbahen nga Mediteran sh.p.k. Megjithatë, pasi që Mediteran sh.p.k nuk mund të kërkoj nga Egje sh.p.k. kthimin e mallrave të pashitur mund të sugjeroj që pronësia e mallrave është transferuar tek Egje sh.p.k.

Konkluzion

Shumica e kushteve të shitjes tregojnë që mallrat nuk janë transferuar të Egje sh.p.k. Mediteran sh.p.k nuk është dashur ta njohë shitjen dhe llogarinë e arkëtueshme. Nuk është dashur po ashtu të ç'njohë stoqet nga librat e saj.

Korigjimet e kërkuara

Të hyrat dhe llogaritë e arkëtueshme të Mediteran sh.p.k duhet të zvogëlohen për €400,000. Përveq kësaj, Mediteran sh.p.k duhet të rrisë stoqet për $(100/125 \times 400,000)$ dhe zvogëloj koston e shitjes për shumën e njejtë. Në përgjithësi, neto pasuritë dhe fitimet e Mediteran sh.p.k do të zvogëlohen për €80,000 $(400,000 - 320,000)$.

Llogaritjet

L11 - Skema adriatik parapagimit	€'000
Detyrimi në fillim (600 - 520)	80
Shpenzimet e pensioneve	600
Pagesat e bëra gjatë vitit	<u>(700)</u>
Parapagimet	20

L12 - Skema jon**Neto fitimet/humbjet nga vlerësimet e eksperteve - llogaritjet**

	€'000
Neto pasuritë e planit me 1 prill 2015	100
Neto të hyrat nga interesi (12% x 100)	12
Kontributete e paguara	160
Kostot e shërbimeve të kaluara	102
Kosto e shërbimeve aktuale	(400)
Neto humbja nga vlerësimet e eksperteve (sal. bal)	<u>(14)</u>
Neto detyrimet e planit me 31 mars 2016	(40)

Neto shpenzimet - llogaritjet

	€'000
Neto të hyrat nga interesi	(12)
Kostot e shërbimeve të kaluara	(102)
Kosto e shërbimeve aktuale	400
Neto shpenzimet	286

Problemi 5

(a) Celtic sh.a mirret me shitjen e paisjeve elektrike, si frigoriferët, soba, televizorë dhe të tjera. Deri me 1 dhjetor 2014 nuk u ka dhënë asnje garancion klienteve për produktet e saj. Me 1 dhjetor 2014, filloi me garancion për dy produktet e saj, frigoriferët dhe televizorët. Garancione një vjeçare dhe dy vjeçare u jipen klientëve të saj për t'i blerë frigoriferët dhe televizorët respektivisht. Kjo është bërë për t'i rritur shitjet e këtyre produkteve.

Çmimi mesatar i frigorifereve dhe televizorëve të kompanisë është €1,800 për frigorifer dhe €5,500 për televizor.

Përgjatë 10 viteve në të cilat kompania ka ekzistuar, shitjet e televizorëve kanë marrë pjesë në 15% të totalit të njësive të shitura të kompanisë, përderisa frigoriferët ishin vetëm 10%. Këto shifra ishin 25% e totalit të njësive të shitura për televizorët dhe 20% për frigoriferët për vitin e përfunduar me 30 nëntor 2015 dhe për vitin e përfunduar me 30 nëntor 2016.

Në vitin e përfunduar me 30 nëntor 2015, 9.5% e shitjeve të televizorëve dhe 5% e shitjeve të frigoriferëve janë kthyer dhe riparuar. Shifrat aktuale për kthimet dhe riparimet për vitin e përfunduar me 30 nëntor 2016 nuk dihen ende. Megjithatë, drejtorët presin që 9% e televizorëve të shitur dhe 6% e frigoriferëve do të kthehen për riparim për shitjet në vitin që përfundon me 30 nëntor 2016.

Shifrat e kostos mesatare e riparimit dhe shitjeve për vitin e përfunduar me 30 nëntor 2015 dhe 30 nëntor 2016 janë si në vijim:

	30 nëntor:	
	2015	2016
Total shitjet (njësi)	100,000	150,000
Kosto e riparimit për njësi:		
Televizor (€)	412.5	412.5
Frigorifer (€)	126.0	126.0

Kompania nuk ka marrë polisë të sigurimit për të mbuluar kostot e riparimit. Për më tepër, grancionet e produkteve nuk janë regjistruara në pasqyrat financiare të Celtic sh.a që nga fillimi i shitjes së tyre.

Shënim: Të gjitha njësitë e shitura hyjnë në garancionet përkatëse dhe injoro skontimin.

Kërkohet:

- (i) Shpjego nëse garancionet e ofruara për produktet nga Celtic sh.a i përmbushin Kriteret të njihen si një provizion në pasqyrat financiare për vitet deri me 30 nëntor 2015 dhe 30 nëntor 2016 në pajtim me SNK 37 *Provizionet, pasuritë kontigjente dhe detyrimet kontigjente.* (6 pikë)
- (ii) Shpjego se si garancionet e produkteve më sipër duhet të kontabilizohen në pasqyrat financiare të Celtic sh.a për vitin e përfunduar me 30 nëntor 2016. (6 pikë)
- (iii) Shpjego se si përgjigja e juaj nën (ii) më lartë do të ishte sikur Celtic sh.a të kishte blerë policë të sigurimit për kostot e riparimit. (2 pikë)

b)

Baltic sh.a është një kompani e listuar në bursë e cila raporton sipas SNRF-ve. Kontabilisti i kompanisë ka kërkuar opinionin tuaj për trajtimin në kontabilitet të zërave në vijim:

- i) Emri i brendit 'The Prime' është bërë mjaft i njohur dhe ka zhvilluar shumë besnikërinë e klientëve që kur kompania u themelua pesë vite më parë. Së fundi, konsulentët e vlerësimit kanë vëndosur një vlerë në brendin për qëllim të shitjes prej €15.5 milion. Drejtorët e Baltic sh.a janë të kënaqur dhe planifikojnë ta njohin brendin si një pasuri të paprekshme në pasqyrat financiare. Ata planifikojnë që ta raportojnë fitimin si një tepricë të rivlërësimit pasi që mendojnë se kreditimi tek fitimi ose humbja mund të jetë e pakujdeshme.
- ii) Kompani ka në pronësi një patentë të cilën e ka blerë dy vite më parë për €7 milion. Është duke e amortizuar përgjatë jetës së saj të dobishme të mbetur prej 14 viteve që nga data e blerjes. Shitjet e produktit të prodhuar janë shumë më mirë se sa është pritur. Konsulentët e vlerësimit kanë vlerësuar vlerën aktuale të tregut të patentës në €12 milion.
- iii) Baltic sh.a ka ndërmarrë një kampanjë të reklamimit për të promovuar produktin e ri. Kampanja e reklamimit e cila u kushtoi €1.5 milion ishte e sukseshme. Drejtorët besojnë që shitjet ekstra të gjeneruara nga kampanja do të jenë shume më të larta se sa ato përgjatë jetës pesëvjeçare të pritur të përdorimit.

Kërkohet:

Këshillo kompaninë për trajtimin në kontabilitet të zërave më sipër në pajtim me SNK 38 *Pasuritë e paprekshme.* (6 pikë)

Totali 20 pikë

Zgjidhja e problemit 5

a)

i) Provizionit është një detyrim i paqartë në kohë ose shumë. Kriteret në vijim duhet të përmbushen që të njihet një provizion në pasqyrat financiare:

- Ka një obligim aktual, qoftë ligjor ose i tërthortë si rezultat i ngjarjeve të kaluara
- Ka shumë mundësi [gjasa] që të nevojitet një transfer i burimeve ekonomike të cilat përmbajnë përfitime ekonomike për të shlyer obligimin në fjalët
- Vlera monetare e obligimit mund të vlerësohet me besueshmëri

Garancionet e produkteve

Celtic sh.a ka një detyrim që rrjedh kur të shet televizorin dhe frigoriferin. Për më tepër, Celtic sh.a pret që disa klientë t'i kthejnë televizorët dhe frigoriferët për riparim. Kjo është e evidentuar nga kthimet aktuale nga klientët në vitin 2015. Andaj, probabiliteti që kompania do të ketë kosto të riparimit në televizor dhe frigorifer është e lartë.

Dhe në fund, shuma e provizionit mund të vlerësohet me besueshmëri duke u bazuar në kostot e riparimit të secilit produkt.

Konkluzion

Garancioni i produkteve duhet të njihet në pasqyrat financiare të Celtic sh.a pasi që përmbush kriteret për njohje si provizion.

ii) Kontabilizimi i garancioneve të produkteve

Televizoret

Celtic sh.a duhet të korigjoj vitin paraprak për €979,687.5 për vitin e përfunduar me 30 nëntor 2015 duke korigjuar saldon fillestare të fitimeve të mbajtura për vitin deri me 30th nëntor 2016. Shifra aktuale lidhur me vitin që përfundoi me 30 nëntor 2015 mirret parasysh për provizionet totale në vitin 2016, pasi që garancioni dy vjeçar nuk ka përfunduar ende. €1,392,187.5 do të njihen si shpenzime në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin deri me 30 nëntor 2016.

Frigoriferet

Provizioni prej €226,800 (L13) duhet të njihet në pasqyrat financiare të Celtic sh.a për vitin deri me 30 nëntor 2016. Megjithatë, një korigjim i vitit paraprak në shumë prej €126,000 (L13) për vitin deri me 30 nëntor 2015 duhet të njihet. Korigjimi i vitit paraprak bazohet në shifrat aktuale.

iii) Efektet nga blerja e policës së sigurimit

Shuma e njohur si provizion nuk do të ndryshonte nëse Celtic sh.a do të sigurohej për kostot e riparimit që rrjedhin nga televizorët dhe frigoriferët të kthyer nga klientët. Anasjelltas, do të ketë nevojë që kompania të njohë të hyra të arkëtueshme nga kompania e sigurimeve sapo shumat të jetë arsyeshmërisht e pranueshme.

Llogritjet

L1	Shitjet në njësi	2015	2016
Televizorët:			
25% x 100,000		25,000	
25% x 150,000			37,500
Frigoriferët:			
20% x 100,000		20,000	
20% x 150,000			30,000
L12 Kthimet			
Të pritura			
Televizorët:			
9% x 37,500 L1			3,375
Frigoriferët:			
6% x 30,000 L1			1,800
Aktuale			
Televizorët 9.5% x 25,000 L1		2,375	
Frigoriferët 5% x 20,000 L1		1,000	
L13 Provizionet			
Total kostot e riparimit:			
Të pritura			
Televizorët:			
3,375 L12 x €412.50			€1,392,187.5
Frigoriferët:			
1,800 L12 x €126.00			€226,800
Aktuale:			
Televizorët 2,375 L12 x €412.50		€979,687.5	
Frigoriferët 1,000 L12 x €126.00		€126,000	

b)

- i) Brendi është një pasuri e paprekshme e 'gjeneruar së brendshmi' e jo e blerë. SNK 38 ndalon njohjen e brendeve të gjeneruari së brendshmi si pasuri mbi bazën që nuk mund të maten me besueshmëri në mungesë të një transaksioni komercial. Andaj brendi nuk mund të njihet si një pasuri në pasqyrën e pozitës financiare.
- ii) Patenta amortizohet deri tek vlera e mbetur zero me €500,000 në vit duke u bazuar në koston e blerjes prej €7 milion dhe jeten e mbetur të përdorimit prej 14 viteve. Patenta nuk mund të rivlerësohet sipas SNK 38 pasi që nuk ka treg aktiv për një patent. SNK 38 nuk lejon rivlerësimin pa një treg aktiv pasi që vlera nuk mund të matet me besueshmëri në mungesë të një transaksioni komercial.
- iii) Kampanja e reklamave trajtohet si një shpenzim dhe normalisht klasifikohet si kosto e shpërndarjes. Shpenzimet e reklamimit nuk mund të kapitalizohen si një pasuri e paprekshme sipas SNK 38 pasi që përfitimet ekonomike që i gjeneron nuk mund të identifikohen qartë, andaj nuk krijohet pasuri e paprekshme.